



GreenAL

Udhëzues për Aplikant

Grante Rajonale dhe të Iniciativës

Kodi i Thirrjes: 16510-G03

Publikuar në 07 Prill, 2025

Aplikimet pranohen deri në datë 12 Maj, 2025 ora 16:00

Tabela e përmbajtjes

1.	Konteksti.....	4
1.1.	Rreth GreenAL	4
1.1.1.	Territori i veprimit dhe partnerët	5
1.2.	Objektivat dhe prioritetet	5
1.3.	Mbështetja financiare.....	6
2.	Kriteret për të aplikuar në këtë thirrje	6
2.1.	Kriteret e përshtatshmërisë.....	6
2.2.	Aplikantët.....	7
2.2.1.	Aplikanti kryesor.....	7
2.2.2.	Bashkë aplikantët:	8
2.2.3.	Aplikant pa buxhet:	8
2.2.4.	Aplikuesit që prahen për secilin LOT	8
2.3.	Qasje	10
2.3.1.	Aktivitetet të lejuara	10
2.3.2.	Aktivitetet të palejuara	11
2.3.3.	Integrimi i perspektivës gjinore	11
2.3.4.	Vizibiliteti.....	13
2.4.	Kostot.....	14
2.4.1.	Kosto të pranueshme	14
2.4.2.	Janë të pranueshme kostot e mëposhtme nga përfituesi i grantit:	14
2.4.3.	Kosto të papranueshme:	15
3.	Tema potenciale	15
3.1.	LOT 1 (Grante Rajonale).....	15
3.2.	LOT 2 (Grante Iniciative)	17
4.	Konsiderata dhe etika.....	17
4.1.	Konsiderata.....	17
4.2.	Etika	18
5.	Procesi i aplikimit dhe dokumentat e nevojshëm	19
5.1.	Aplikimi	19
5.1.1.	Dokumentacioni i nevojshëm.....	19

5.1.2.	Mënyra e aplikimit	20
5.1.3.	Afati i fundit për të dërguar aplikimin e plotë	20
5.1.4.	Informacione të mëtejshme rreth aplikimit të plotë	20
5.2.	Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikimeve	21
5.3.	Zhvillimi i dëgjësës	25
5.4.	Procedura e përzgjedhjes	25
5.4.1.	Njoftimi i vendimit nga ana e Co-PLAN	26
5.5.	Kontraktimi:	26
5.6.	Kontratat, raportimet dhe pagesat përfundimtare	26
5.7.	Kalendar Indikativ i Procesit	27

Shënim:

Ky udhëzues ofron informacionin e nevojshëm për të gjithë Organizatat e Shoqërisë Civile në Shqipëri, që janë të interesuara për të aplikuar në thirrjen për Grante Rajonale dhe të Iniciativës të GreenAL. Udhëzuesi shpjegon qasjen, kriteret dhe rregullat e thirrjes. Për çdo informacion ose paqartësi, mund të na shkruani në info@greenal.al.

1. Konteksti

Çështjet mjedisore po marrin gjithnjë e më shumë vëmendje nga qeveria, qytetarët dhe donatorët, për shkak të efekteve të krizës së trefishtë planetare: ndryshimi i klimës, ndotja dhe humbja e biodiversitetit, të cilat po kthehen në një kërcënim real dhe ekzistencial për komunitetet në të gjithë territorin e vendit.

Në këtë kontekst, roli i Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) merr një rëndësi të madhe, pasi ato luajnë një rol kyç jo vetëm në advokimin e shqetësimeve mjedisore, por edhe në ndikimin aktiv në proceset e politikbërjes duke siguruar që komunitetet të jenë të përfaqësuara dhe që zhvillimi ekonomik është në paralel me atë social e mjedisor, e jo në kurriz të tyre.

Në kuadër të Thirrjes për Grante Tematike dhe Rajonale të GreenAL, janë mbështetur disa iniciativa në nivel kombëtar dhe rajonal, të fokusuara në tre fusha kryesore: Ndryshimet Klimatike, Ndotja dhe Natyra. Për të mbështetur adresimin e çështjeve mjedisore në nivel lokal, GreenAL lançon Thirrjen për Grantet Rajonale dhe të Iniciativës, duke synuar forcimin e kapaciteteve për identifikimin, zhvillimin dhe adresimin e sfidave mjedisore në nivelet rajonale dhe lokale.

Nëpërmjet kësaj thirrje do të alokohen deri në gjashtë (6) grante rajonale dhe njëzet (20) grante iniciative. OSHC-të që aplikojnë për grantet rajonale duhet të përqendrojnë veprimtarinë e tyre të propozuar në një rajon që përfshinë disa Bashki/Qarqe, ndërsa grantet e iniciativës duhet të mbështesin veprimtarinë në nivel bashkie ose njësie administrative, aty ku organizatat kanë legjitimitet dhe përvojë të drejtpërdrejtë për të adresuar çështjet lokale.

Përmes kësaj thirrjeje synojmë të integrojmë një qasje poshtë-lart të trajtimit të çështjeve mjedisore, duke lidhur nivelin komunitar me atë të politikbërjes. Kjo mundëson hapsirë për integrimin e çështjeve me rëndësi lokale në politika më të gjera dhe potencialisht në agjendat/proceset kombëtare.

1.1. Rreth GreenAL

Projekti 'Mbështetja e Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile' GreenAL mbështetet financiarisht nga nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Sida, me fondet e Qeverisë Suedeze dhe zbatohet nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit në bashkëpunim me organizatat, VIS Albania dhe COSV - Cooperazione per lo Sviluppo.

GreenAL ndërton mbi praktikën e mira dhe mësimet e nxjerra të fazës së parë të tij (2021-2023). Gjatë katër viteve (2024-2027) GreenAL synon të fuqizojë OSHC-të mjedisore Shqiptare, kryesisht ato me fokus mjedisor, por jo vetëm, për të:

- ngritur problematika mjedisore që prekin komunitetet në territore të ndryshme të vendit;
- nxitur advokimin të bazuar në fakte/monitorime;
- nxitur pjesëmarrje në proceset e politikbërjes nga niveli lokal në atë kombëtar.

Nëpërmjet GreenAL OSHC-të do të kenë mundësinë të marrin pjesë dhe kontribuojnë në mënyrë efektive në procesin e negociatave për anëtarësimin në BE, me fokus kryesor Kapitullin 27 – Mjedi duke synuar angazhim të drejtpërdrejtë në proceset politikbërëse dhe forcimin e transparencës e gjithëpërfshirjes në vendimarrje.

1.1.1. Territori i veprimit dhe partnerët

Projekti GreenAL zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për të siguruar një menaxhim të mirë të projektit dhe një mbështetje të vazhdueshme të organizatave dhe grupeve të interesit, prezenca e GreenAL në territorin e vendit ka përfaqësim të ndryshëm në 3 rajonet kryesore, me një Partner përgjegjës për secilën territor:

- **Rajoni Verior**, i cili përfshin qarqet Kukës, Dibër, Shkodër dhe Lezhë, është nën përgjegjësinë e partnerit VIS Albania.
- **Rajoni Qendror**, i cili përfshin qarqet Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Fier, është nën përgjegjësinë e partnerit Co-PLAN.
- **Rajoni Jugor**, i cili përfshin qarqet Vlorë, Berat, Korçë, Gjirokastrë, është nën përgjegjësinë e partnerit COSV.

Secili nga Partnerët do të ofrojë asistencë dhe mentorim për të gjithë përfituesit e granteve të cilët do të duan të aplikojnë e zbatojnë projekte në rajonet respektive.

1.2. Objektivat dhe prioritetet

Qëllimi i kësaj thirrjeje është të ofrojë mbështetje financiare për organizatat e shoqërisë civile me fokus mjedisor, me synim rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të tyre për të ndikuar në mënyrë aktive dhe të strukturuar në proceset e politikëbërjes në nivel lokal dhe rajonal. Kjo përfshin adresimin e sfidave mjedisore që prekin komunitetet dhe territoret ku ato operojnë.

Objektivat specifikë janë:

- **Rritja e kapaciteteve të OSHC-ve** për të gjeneruar dhe udhëhequr dialogun mjedisor në nivelet lokale dhe rajonale, përmes monitorimit të problematikave dhe advokimit të bazuar në të dhëna për politika më të mira në fushat e klimës, ndotjes dhe mbrojtjes së natyrës;
- **Fuqizimi i rolit të OSHC-ve si partnerë të besueshëm** të institucioneve publike dhe aktorëve të tjerë, në procesin e hartimit dhe zbatimit të reformave mjedisore, me fokus të veçantë në Kapitullin 27 dhe tranzicionin drejt një ekonomie të gjelbër;
- **Ndërgjegjësimi dhe mobilizimi i komuniteteve**, për të rritur presionin pozitiv mbi vendimmarrësit në çështje si mbrojtja e biodiversitetit dhe habitateve, reduktimi i ndotjes, dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, përmes rritjes së kërkesës për llogaridhënie dhe veprim konkret.

1.3. Mbështetja financiare

Vlera totale e vënë në dispozicion për këtë thirrje është 640,000 EURO. Co-PLAN rezervon të drejtën për të mos akorduar të gjithë shumën e vënë në dispozicion nëse nuk ka një numër të mjaftueshëm propozimesh apo nëse ato nuk janë në cilësinë e duhur për tu shpallur fitues.

Çdo grant i kërkuar në këtë thirrje duhet të akomodohej brenda limiteve të mëposhtme, varësisht aktiviteteve apo produkteve që organizatat planifikojnë për të realizuar qëllimin e projekt-propozimit.

Moduli	Vlera e Grantit (EUR)	Kohëzgjatja (Muaj, Min-Max)	Aplikuesi	Partneriteti
LOT 1 Grante Rajonale (max. 6)	50,000	18- 24 Muaj	OSHC mjedisore	1 detyrueshëm – minimalisht me 2 OSHC të tjera
LOT 2 Grante Iniciative (max. 20)	17,000	12-18 Muaj	OSHC mjedisore	Jo i detyrueshëm (maksimalisht 1 OSHC tjetër)

Tek **LOT 1 lejohet kryerja e investimeve **deri në 25% të buxhetit** total të kërkuar. Mos parashikimi i kryerjes së investimeve nuk është kriter penalizues.*

2. Kriteret për të aplikuar në këtë thirrje

Për të aplikuar në këtë thirrje do të aplikohen kriteret si më poshtë.

2.1. Kriteret e përshtatshmërisë

Kriteret e përshtatshmërisë përcaktojnë kushte të rëndësishme që aplikantët dhe aktivitetet e tyre duhet të përmbushin për të qenë të pranueshëm në këtë thirrje. Ky seksion shpjegon kërkesat për aplikantët, llojet e aktiviteteve që mund të mbështeten dhe udhëzimet për menaxhimin e kostove, duke garantuar që vetëm projektet që kanë kapacitet dhe përputhen me prioritetet e thirrjes të marrin mbështetje.

Ekzistojnë tre grupe kriteresh të përshtatshmërisë, që kanë të bëjnë me:

1. Aplikantët (2.2)

- Aplikuesi kryesor, i cili do të jetë përgjegjës për dorëzimin e dokumentave;
- Bashkë aplikantët, të cilët së bashku me aplikantin kryesor përbëjnë partneritetin i cili do të aplikojë në këtë thirrje;
- Aplikanti/ët pa buxhet, të cilët mund të jenë pjesë e një partneriteti në të dyja LOT-et e kësaj thirrje.

2. Qasje (2.3)

- Qasje që mund të aplikohen dhe aktivitete të lejuara;
- Aktivitete të palejuara;
- Integrimi i perspektivës gjinore;
- Vizibiliteti.

3. Kostot (2.4):

- Llojet e kostove që mund të merren parasysh në përcaktimin e shumës së grantit.

2.2. Aplikantët

2.2.1. Aplikanti kryesor

Për të dyja LOT-et

Aplikanti kryesor (lideri) duhet të përmbush kriteret e mëposhtme për të aplikuar:

1. Të jetë Organizatë jofitimprurëse (OJF) e regjistruar sipas ligjit nr. 8788 datës 07.05.2011 “Për organizatat jofitimprurëse”;
2. Të jetë organizatë që ka në fokusin e saj mjedisin dhe mbrojtjen e promovimin e habitateve, e specifikuar në statutin e organizatës si dhe të ketë eksperiencë të mëparshme në projekte mjedisore (të listuara në CV-në e organizatës);
3. Të jetë përgjegjës për dorëzimin e projekt propozimit, nënshkrimin e kontratës së grantit në rast se propozimi shpallet fitues;
4. Të jetë përgjegjës i drejtpërdrejtë për menaxhimin e projektit, ku duhet të kontribuoj në mënyrë aktive me bashkë aplikantët, dhe jo të veprojnë si ndërmjetësues;
5. Të marrin në konsideratë bashkëpunimin me një nga aktorët e listuar në pikën (2.2.3);
6. Aplikanti kryesor duhet të ketë një marrëveshje partneriteti të shkruar me bashkë aplikantët dhe/ose aplikantët pa buxhet. Në marrëveshje duhet të **specifikohet roli specifik i gjithësecilit prej partnerëve** dhe angazhimi që ata do të kenë lidhur me zbatimin e aktiviteteve dhe projektit në tërësi;
7. Eksperiencë të mëparshme pune apo angazhimi në rrjete do të konsiderohet vlerë e shtuar.

Për LOT 1 (Grante Rajonale):

1. Aplikanti kryesor (lideri) duhet të ketë minimalisht 5 vite eksperiencë (5 vite nga regjistrimi në Gjykatë);
2. Aplikanti kryesor i cili ka dëshirë të aplikojë në LOT 1 **duhet të formojë** me doemos **një partneritet** i cili përfshin **minimalisht 2 OSHC** (3 OSHC në total);
3. Aplikanti kryesor duhet ti japi prioritet formimit të partneritetit me organizata të cilat operojnë në rajonin në të cilët do të zbatohet projekti. Për të kërkuar partnerë potencial në rajonet specifike mund ti referoheni [bazës së të dhënave](#) në faqen e GreenAL. Në pamundësi për të formuar një partneritet të suksesshëm me OSHC lokale, aplikanti kryesor duhet të justifikoj përzgjedhjen e partnerëve të cilët nuk janë OSHC lokale dhe vlerën e shtuar që ata sjellin në projekt.

Për LOT 2 (Grante Iniciative):

1. Aplikanti kryesor (lideri) duhet të ketë minimalisht 5 vite eksperiencë (5 vite nga regjistrimi në Gjykatë).

2.2.2. Bashkë aplikantët:

- Të jetë Organizatë jofitimprurëse (OJF) e regjistruar sipas ligjit nr. 8788 datë 07.05.2011 “ Për organizatat jofitimprurëse”.
- Të kenë minimalisht 1 vit eksperiencë (1 vit nga regjistrimi në Gjykatë);
- Të jenë operativ/ushtrojnë funksionin e tyre në rajonin në të cilin do të aplikojnë;
- Të ketë eksperiencë të mëparshme në projekte mjedisore (të listuara në CV e organizatës).

2.2.3. Aplikant pa buxhet:

Bashkëpunimi me këta aplikant mbetet në gjykimin e aplikantit kryesor, duke marrë në konsideratë vlerën e shtuar që ata sjellin në projekt. Në të gjitha rastet roli i tyre duhet të dali qartë në projekt propozim. Një listë jo shteruese të këtyre aktorëve paraqitet si më poshtë:

- Organizime apo grupe jo-formale rinore, kulturore, gjinore, etj.;
- Departamente nga Fakultete Publike dhe Private;
- Institute Kërkimore e Arsimore;
- Operatorë ekonomik;
- Institucione publike si Bashki, Njësi Administrative etj.;
- Agjenci Rajonale apo Kombëtare etj.

2.2.4. Aplikuesit që pranohen për secilin LOT

LOT 1	Aplikant kryesor	Bashkëaplikant
Organizatat që kanë përfituar nga thirrja 16510-G02¹ (2024-2027) si aplikant kryesor , nuk mund të aplikojnë për të qenë aplikant kryesor ose bashkëaplikant në këtë thirrje	Jo	Jo

¹ Skema e pare e Granteve në kuadër të GreenAL (2024-2027) - GRANTE PËR FUQIZIMIN E ORGANIZATAVE MJEDISORE NË SHQIPËRI /MODULI PËR GRANTET TEMATIKE DHE RAJONALE, janar 2025.

Organizatrat që kanë përfituar nga Grantet Rajonale si pjesë e thirrjes 16510-G02 si bashkëaplikant mund të aplikojnë deri në një (1) herë në LOT 1 si bashkëaplikant .	Jo	Po (1x)
Organizatrat mund të aplikojnë deri në dy (2) herë si bashkëaplikant në LOT1.	P/A	Po (2x)
Një oganizatë mund të aplikojë si bashkëaplikant në LOT 1 dhe LOT 2 njëherësh.	P/A	Po (2x: 1 herë për secilin Lot)
Organizatrat që aplikojnë si aplikant kryesor në LOT 1 nuk mund të aplikojnë më në këtë thirrje.	Po (x1)	Jo
Aplikantët pa buxhet me të cilat OSHC-të mund të lidhin partneritet (listuar në 2.2.3) nuk kanë kufizime për aplikimet e tyre.	—	—

LOT 2	Aplikant kryesor	Bashkë aplikant
Organizatrat që kanë përfituar nga thirrja 16510-G02 (2024-2027) si aplikant kryesor , nuk mund të aplikojnë për të qenë aplikant kryesor ose bashkëaplikant në këtë thirrje	Jo	Jo
Organizatrat që kanë përfituar nga Grantet Rajonale si pjesë e thirrjes 16510-G02 si bashkëaplikant , mund të aplikojnë si aplikant kryesor ose bashkëaplikant për LOT 2 në këtë thirrje.	Po (1x)	Po (1x)
Organizatrat të cilat aplikojnë si bashkë aplikant për LOT 1 , mund të aplikojnë si aplikant kryesor ose si bashkëaplikant në LOT 2.	Po (1x)	Po (1x)
Organizatrat mund të aplikojnë vetëm një (1) herë si aplikant kryesor në LOT 2.	Po (1x)	P/A
Organizatrat mund të aplikojnë deri në dy (2) herë si bashkëaplikant në LOT 2.	P/A	Po (2x)
Aplikantët pa buxhet me të cilat OSHC-të mund të lidhin partneritet (listuar në 2.2.3) nuk kanë kufizime për aplikimet e tyre	—	—

2.3. Qasje

Në këtë thirrje, pritët që OSHC-të të aplikojnë qasjet e mëposhtme (kjo listë nuk është shteruese).

Sqarim: Aplikimi i një qasje mund të përbëhet nga zbatimi i një sërë aktiviteteve.

Për të dy LOT-et:

- Të përfshihen në procesin dhe dialogun me politikëbërësit lokal/rajonat;
- Të angazhojnë dhe mbështesin komunitetet apo grupimet e ndryshme në kërkesat e tyre për një mjedis të shëndetshëm apo në mbrojtje të habitatit;
- **Të prezantojnë modele inovative në menaxhimin dhe monitorimin e mjedisit, angazhimin e komunitetit e të rinjve, promovimit të çështjeve të trajtuara në nivel lokal/rajonat;**
- Të përdorin mjete komunikimi tradicionale dhe novatore për të ndikuar në adresimin e problematikës së ngritur;
- Të aplikojnë praktika të cilat ndikojnë në rritjen e kapaciteteve të OSHC-ve dhe komuniteteve;
- Të organizojnë fushata advokimi mbi alternativën më të mirë për zgjidhjen e çështjes mjedisore;
- Të mbështesë iniciativa e praktika të suksesshme në kuadër të mbrojtjes, promovimit dhe bashkëpunimit ndërmjet palëve në fushën e mjedisit;
- **Të ofrojnë alternativa për zgjidhjen e problematikës së ngritur nëpërmjet hartimit të dokumenteve/letrave të pozicionimit, raporteve, artikujve shkencor e informues;**
- Të mbështesin kërkimin dhe raportimin të bazuar në fakte dhe të dhëna nga terreni duke përfshirë në mënyrë aktive qytetarët;
- Të përfshihen në procese rrjetëzimi, veçanërisht GreenAL, dhe shkëmbimi eksperiencash në nivel kombëtar e rajonal (ballkanik, evropian).

2.3.1. Aktivitete të lejuara

Më poshtë paraqitet një listë jo shteruese e aktiviteteve të cilat mund të parashikohen nga aplikantët:

- Zhvillimi i aktiviteteve të cilat mundësojnë dialogun ndërmjet grupeve të interesit;
- Iniciativa të cilat mbështesin komunitetet dhe kërkesat e tyre;
- Mbështetje teknike për iniciativat komunitare;
- Hartimi i rekomandimeve apo letrave të pozicionimit për çështje mjedisore;
- Zhvillimi i puntorive/workshop-eve dhe trajnimi i komuniteteve;
- Përfshirja/angazhimi i komuniteteve në proceset e vlerësimit dhe monitorimit mjedisor (angazhimi i qytetarëve në monitorimin e ofrimit të shërbimeve, vlerësimin e biodiversitetit, elementëve mjedisor);
- Zhvillimi i konferencave për të ndarë arritjet dhe rritur ndërgjegjësimin e grupeve të interesit;
- Dokumentimi dhe publikimi i praktikave të mira;
- Zhvillimi i fushatave informuese në rrjete sociale dhe media tradicionale për të rritur ndërgjegjësimin;
- Realizimi i videove të cilat ilustrojnë problematikën, arritjet, angazhimin komunitar etj.;

- Zhvillimi i puntorive/workshop-eve për rritjen e kapaciteteve të OSHC-ve;
- Lehtësimi i shkëmbimit të praktikave të mira apo rasteve të ngjashme në vend dhe ballkanin perëndimor, potencialisht edhe atë evropian;
- Organizimi i eventeve dhe lehtësimi i rrjetëzimit;
- Hartimi dhe publikimi i raporteve dhe rishikimi i legjislacionit lokal dhe/ose rajonal.

Vetëm për LOT 1 (Grante Rajonale):

Lejohet kryerja e **investimeve*** të cilat janë në linjë me arritjen e objektivave të projekt propozimit. Realizimi i këtij investimi duhet **të ketë impakt apo të ndikojë në përmirësimin e situatës aktuale**. Në rast se parashikohet kryerja e një investimi **duhet të sigurohet vazhdimësia e mirëmbajtjes së investimit të kryer**.

**Investimet duhet të lidhen ngushtësisht me zgjidhjet e propozuara apo adresimin e problematikës së ngritur nga aplikuesi/t dhe përfituesit final të jenë grupet e interesit dhe komuniteti.*

Investimet NUK mund të përdoren për të financuar një detyrim që i përket autoriteteve/institucioneve shtetërore.

2.3.2. Aktivitete të palejuara

- Veprime që kanë të bëjnë vetëm ose kryesisht me sponsorizime individuale për pjesëmarrje në seminare, konferenca dhe kongrese;
- Veprimet që kanë të bëjnë me bursa individuale për studime ose kurse trajnimi;
- Veprimet që kanë të bëjnë vetëm ose kryesisht me vizita studimore ose pjesëmarrje në forume ndërkombëtare;
- Blerja e paisjeve për mobilimin e zyrave apo të tilla si laptop, aparate fotografike, dron e të ngjashme;
- Blerja e tokës, ndërtesave ose zyrave;
- Aktivitetet e ndërmarra para nënshkrimit të kontratës;
- Veprime që synojnë aktivitete fitimprurëse;
- Veprimet e financuara tashmë nga programe të tjera;
- Veprimet diskriminuese ndaj individëve ose grupeve të njerëzve në bazë të gjinisë, orientimit seksual, besimeve fetare ose origjinës së tyre etnike;
- Veprime në mbështetje të partive politike apo individëve të cilët kandidojnë për këto parti.

2.3.3. Integrimi i perspektivës gjinore

Çështjet e mjedisit dhe klimës janë po aq edhe çështje sociale, ekonomike dhe politike. Për këtë arsye, GreenAL dhe Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Sida, e konsiderojnë thelbësore që bashkë me sfidat mjedisore të adresohen dhe merren parasysh edhe pabarazive gjinore për një shoqëri të drejtë dhe të barabartë.

Integrimi i perspektivës gjinore në nismat që adresojnë sfida mjedisore dhe klimatike siguron që nevojat, përvojat dhe kontributet unike të të gjitha gjinive të merren parasysh, duke çuar në zgjidhje gjithëpërfshirëse dhe efektive për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

Në këtë drejtim GreenAL, në kuadër të kësaj thirrje për propozime, kërkon dhe inkurajonë aplikantët të integrojnë perspektivën gjinore në projekt propozimet që do të dorëzojnë.

GreenAL synon të sigurojë që perspektiva gjinore është integruar në të gjitha ose pjesën më të madhe të iniciativave të mbështetura nga kjo thirrje, ku përfituesit e granteve kanë kapacitetet që të sjellin projekte dhe nisma që i përgjigjen më së miri dhe adresojnë nevojat, interesat dhe përvojat e ndryshme të burrave/djemëve dhe grave/vajzave në zonën ku do të zbatohet projektit për sa i përket impaktit të ndryshimeve klimatike, ndotjes e pasojat e tyre në burimet natyrore.

Sugjerojmë dhe inkurajojmë që para dhe gjatë hartimit të projekt propozimeve të merren në konsideratë elementë të paraqitur më poshtë:

1. Hartimi një dokumenti kuadër ku të trajtohen çështje të barazisë gjinore të cilat do të udhëheqin procesin e hartimit të projekt propozimit në këtë aspekt;
2. Ndërmerrni një analizë gjinore² të problematikës që ju do të adresoni për të mësuar më shumë mbi përvojat, nevojat dhe kufizimet e burrave dhe grave që do të përfitojnë nga projekti juaj. Kjo mund të bëhet nëpërmjet mbledhjes së të dhënave mbi target grupin tuaj në përgjithësi, të ndara në bazë të gjinisë /seksit, ose karakteristikave të tjera. Raporte, studime, statistika të nxjerra nga INSTAT ju ndihmojnë për këtë ose ndërmerrni studimin tuaj, realizoni konsultime të ndara midis burrave dhe grave, konsultohuni me grupe të interesuara.
3. Pasi keni realizuar analizën gjinore dhe keni identifikuar nevojat, përvojat, kufizimet hartoni objektiva dhe tregues/ indikator specifikë gjinorë:
 - Objektivat gjinorë specifikë duhet ti përshtaten fushës së ndërhyrjes dhe të jenë formuluar si objektiva mbi performancën në avancimin e barazisë gjinore në një entitet të caktuar, pjesëmarrjen dhe impaktin.
 - Tregues (indikator) të ndjeshëm gjinorë: të cilat na lejojnë për të matur ndryshimet në marrëdhënien midis grave dhe burrave, statusin e tyre, nevojat dhe situata në kontekstin e projektit dhe aktivitetëve;
4. Promovoni pjesëmarrjen e grave ose gjinisë më pak të përfaqësuar në të gjitha ciklet e projektit dhe vendimmarrjes. Inkurajoni dhe promovoni përfshirjen e barabartë dhe cilësore të burrave dhe grave në hartimin e projekt propozimit, implementimin, monitorimin dhe vlerësimin e tij. Njëkohësisht promovoni pjesëmarrjen e grave në pozicione vendimmarrëse.
5. Përkrahni veprimet ose qasjet që projekti do të aplikojë për promovimin e barazisë gjinore dhe sigurohuni që të aplikoni parimet e barazisë gjinore lidhur me aktivitet tuaja: të jenë të aksesueshme, përfituese dhe të përfshijnë të gjitha gjinitë;

² Analiza gjinore shqyrton marrëdhëniet midis grave/vajzave dhe burrave/djemve dhe kufizimet me të cilat ato përballen me njëri-tjetrin në arritjen e barazisë gjinore në një fushë të caktuar politike, mjedisore, sociale, situatë ose kontekst. Analiza gjinore mund të kryhet në bazë të informacionit dhe metodave cilësore dhe/ose bazuar në informacionin sasior të siguruar nga statistikat me bazë gjinore.

6. Parashikoni masa mbështetëse ose lehtësuese për gjininë më pak të përfaqësuar, si financim i pjesëmarrësve, financimi për rritjen e kapaciteteve të stafit mbi barazinë gjinore, si dhe vendndodhja dhe koha e realizimit të aktiviteteve;
7. Parashikoni dhe përshkruani mënyrat sesi do të shpërndahet informacioni tek burrat dhe gratë ku do të zbatohet projekti për një pjesëmarrje dhe përfitim të barabartë të të dy gjinive;
8. Mblidhni të dhëna të ndara në bazë të gjinisë ose karakteristikave të tjera kur e shihni të mundëshme;
9. Përdorni një gjuhë të ndjeshme gjinore në hartimin e projektit, gjatë zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të tij;
10. Produktet dhe materialet e prodhuara nga projekti, të jenë të ndjeshme ndaj gjinisë dhe raportimi i gjetjeve, konkluzioneve e rekomandimeve të kryhet i ndarë sipas gjinisë.

2.3.4. Vizibiliteti

GreenAL e konsideron komunikimin dhe vizibilitetin si një element tepër të rëndësishëm në promovimin e punës së kryer dhe përcimit të mesazheve me qëllim ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe grupeve të interesit. GreenAL sugjeron aplikantët që në propozimet e tyre të përfshijnë aktivitete dhe materiale për promovimin e projektit që ata/ato do të zbatojnë. Komponenti i komunikimit duhet të zë minimalisht 2% të totalit të buxhetit të kërkuar.

Për të arritur një audiencë më të gjerë dhe amplifikuar mesazhin, rezultatet e aktiviteteve dhe arritjeve të projektit tuaj, GreenAL mbështet bashkëpunimin me median e shkruar dhe audio-vizuale qoftë ajo lokale, rajonale apo kombëtare.

Në varësi edhe të projekt idesë e çështjes që ju kërkon të adresoni mjete/materiale vizibiliteti konsiderohen, por nuk kufizohen në:

- **Rrjete sociale**, përdorimi i rrjeteve sociale si *Facebook, Instagram, You-Tube* janë kthyer tanimë si një mjet alternativ tepër eficient për promovimin e aktiviteteve të projektit dhe projektit në vetvete, për këtë arsye ne do të sugjeronim përdorimin e rrjeteve sociale ekzistuese të organizatës apo bashkë aplikantëve;
- **Broshura** fletë palosje në format digjital, me mesazhe specifike në varësi të çështjes që ju ngrini. (printimi i broshurave fizike nuk është opsioni më i preferuar, megjithatë në rast se konsiderohet e domosdoshme, printim i tyre duhet të jetë relativisht i limituar në numër dhe të artikullohet qartë vlera e tyre nëse do të përdoren).
- **Produkte digjitale**, gjenerimi i videove (të cilat ilustrojnë problematikën, procesin, angazhimin komunitar), infografikë dhe reportazhe.
- **Media e shkruar dhe audiovizive**, artikuj, intervista pjesëmarrja në emisione apo debate publike.

2.4. Kostot

Vetëm "kostot e pranueshme" mund të merren parasysh për një grant. Kategoritë e kostove të konsideruara si të pranueshme dhe jo të pranueshme paraqiten si më poshtë. Vini re, se kostot e pranueshme duhet të bazohen në kosto reale referuar në dokumentet mbështetëse.

Rekomandimet për dhënien e një granti gjithmonë i nënshtrohen një procesi të negocimit dhe kontrollit para nënshkrimit të kontratës. Procesi i negocimit dhe kontrollit ka për qëllim të nxjerrë në pah dhe adresojë probleme që kërkojnë ndryshime në buxhet (për shembull gabime aritmetike, pasaktësi ose kosto jo reale dhe kosto të tjera të papranueshme) dhe njëkohësisht të vlerësojë mundësinë që organizata ka për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i projektit.

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit gjatë procesit të negocimit të kontratës mund të sugjerojë modifikime ose ulje në shumën e grantit të kërkuar, në rast se vërehen gabime ose pasaktësi të tilla. Shuma e grantit, si rezultat i këtyre korigjimeve, nuk mund të rritet, për këtë arsye është në interesin e aplikantit të sigurojë një buxhet realist dhe me kosto efektive.

2.4.1. Kosto të pranueshme

Kostot e pranueshme janë ato kosto që:

1. janë zhvilluar gjatë zbatimit të aktiviteteve siç specifikohet në kontratë. Kjo do të thotë që kostot kanë të bëjnë me aktivitetet e kryera gjatë periudhës së zbatimit;
2. pasqyrohen në buxhetin e përgjithshëm të aktivitetit (në formatin e aneksuar të buxhetit);
3. janë të nevojshme për zbatimin e aktiviteteve;
4. mund të gjurmohen dhe verifikohen në origjinë, veçanërisht të regjistruara në regjistrat kontabël të përfituesit të grantit dhe të përcaktuara në përputhje me standardet e zbatueshme të kontabilitetit të Republikës së Shqipërisë;
5. janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm tatimor;
6. respektojnë rregullat e kombësisë dhe origjinës.

2.4.2. Janë të pranueshme kostot e mëposhtme nga përfituesi i grantit:

- kostot e stafit të caktuar në projekt-propozim, që korrespondojnë me pagat aktuale bruto duke përfshirë tarifat e sigurimeve shoqërore dhe kostot e tjera të lidhura me shpërblimin;
- shpenzimet e udhëtimeve dhe dietave për personelin dhe personat e tjerë që marrin pjesë në projekt, me kusht që të jenë kosto reale të konfirmuara nga dokumente mbështetëse;
- kostot e blerjeve për pajisje (të reja ose të përdorura) dhe shërbime/punë të posaçme të cilat lidhen ngushtësisht me realizimin e ndërhyrjes që do të kryhet dhe projektit. E aplikueshme vetëm në rastin e granteve rajonale;
- kosto për zhvillimin e aktiviteteve të parashikuara në projekt propozim;
- kosto për kontraktimin e ekspertizës së nevojshme të parashikuar në projekt propozim.
- Kosto per audit financiar

E rëndësishme: Taksat, përfshirë TVSH-në do të aprovohen si kosto të pranueshme vetëm kur të plotësohen kushtet e mëposhtme (dhe të konfirmuara nga dokumentet mbështetëse):

- taksat e vlerës së shtuar nuk janë të rimbursueshme në asnjë mënyrë;
- sipas praktikës, ato do të përballohen nga përfituesi; dhe
- ato pasqyrohen qartë në projekt propozim.

2.4.3. Kosto të papranueshme:

Kostot e mëposhtme nuk do të konsiderohen të pranueshme:

- borxhe dhe tarifat e shërbimit të borxhit (interesat);
- dispozita për humbje ose detyrime të mundshme në të ardhmen;
- kosto të deklaruara nga përfituesi dhe të financuara nga donatorë ose nga veprime të tjera të financuara nga Sida;
- humbjet e këmbimit valutor;
- kredi për palët e treta;
- kostot e pagave të personelit të administratës shtetërore, publike.

3. Tema potenciale

GreenAL sugjeron aplikuesit që t'i referohen dhe të konsiderojnë adresimin e temave të pasqyruara, shkurtimisht më poshtë dhe më gjerësisht në [Pasqyra e Programit GreenAL](#). Temat e paraqitura më poshtë janë vetëm disa shembuj ilustrativ dhe aplikantët mund të zgjedhin çështje të tjera apo ndërthurje të tyre.

Nuk do të konsiderohet e penalizuar një organizatë apo një partneritet organizatash të cilat paraqesin një aplikim i cili sjell risi apo është aktual për rajonin në të cilin aplikohet, por duhet të jetë në linjë me kërkesat e thirrjes.

3.1. LOT 1 (Grante Rajonale)

Aplikuesit për LOT 1 do të duhet të kenë kapacitete (teknike, financiare e burime njerëzore) të provuara për të adresuar çështjen e përzgjedhur si dhe kontakte të mira lokale. Nën këtë skemë grantesh partneriteti i organizatave që aplikon ka mundësi të ndërmarri veprime konkrete, kryej investimeve, për përmirësimin e gjendjes mjedisore.

E rëndësishme: Aplikuesit për LOT 1 do të duhet të bashkëpunojnë ngushtësisht me organizatat lokale dhe të angazhohen me grupet e interesit për të përcjell zërin e komuniteteve për të nxitur advokimin të bazuar në fakte/monitorime dhe pjesëmarrje në proceset e politikbërjes në nivel lokal e rajonal duke synuar rritjen e transparencës dhe gjithëpërfshirjes në vendimarrje.

Disa sygjerime mbi temat që mund të trajtohen për këtë LOT janë:

- Partneriteti për menaxhimin e mbetjeve/ekonominë qarkulluese

Nën këtë temë mund të trajtohet tema aktuale e menaxhimit të mbetjeve dhe promovimi i konceptit të ekonomisë qarkulluese duke u nisur nga një vlerësim i situatës aktuale për të propozuar praktika të mira të cilat mund të aplikohen në kontekstin lokal/rajonat.

- **Partneriteti për restaurimin e habitateve**

Duke parë edhe presionin e rritur ndaj burimeve natyrore në vend mund të synohet vlerësimi i habitateve për të kuantifikuar vlerën e tyre duke zbatuar apo propozuar veprime konkrete për restaurimin e tyre.

- **Partneriteti për transport publik të qendrueshëm**

Nën këtë çështje mund të trajtohet gjendja aktuale e transportit në bashki apo rajone specifike të vendit duke vlerësuar funksionalitetin, aksesueshmërinë dhe impaktin mjedisor që ky shërbim ka aktualisht në mjedis.

- **Partneriteti i veprimit ndaj ndryshimeve klimatike**

Nën këtë çështje mund të kombinohet impakti që ndryshimet klimatike kanë në territore, komunitete apo fusha të caktuara duke rritur ndërgjegjësimin e grupeve të interesit dhe angazhuar në nivel lokal e rajonal për adresimin e problematikave.

- **Partneriteti për efikasitet dhe energji të rinovueshme**

Ky partneritet mund të synojë të trajtojë rritjen e ndërgjegjësimin në nivel lokal e rajonal të promovimit të praktikave të mira të efikasitetit dhe energjisë së rinovueshme duke u nisur nga një vlerësim i situatës aktuale në zonën në të cilën do të duan të zbatojnë projektin.

- **Partneriteti për monitorimin e shërbimeve e ekosistemit dhe cilësisë së tokës urbane***

Duke parë rritjen e urbanizimit të qyteteve kryesore në vend dhe reduktimin e hapësirave të gjelbërta do të ishte me interes të kryhej monitorimi i shërbimeve të ekosistemit duke paraqitur situatën aktuale, përfshirë që komunitetet dhe qyteti ka prej tyre, duke e ndërlidhur me monitorimin e cilësisë së tokës në parqet urbane për të kuptuar nëse ka ndotje dhe si ndikon ajo në zhvillimin e ekosistemit. Këtu mund të synohet si vlerësimi sasior apo cilësor i këtyre shërbimeve si dhe cilësia e tokës së parqeve publike në 6 bashki të vendit (Tiranë, Elbasan, Korçë, Shkodër, Durrës, Fier).

***SHËNIM:** Aplikantët të cilët duan të kryejnë monitorimin e ajrit dhe zhurmave, cilësisë së ujërave, shërbimeve të ekosistemit dhe tokës urbane, do të duhet të bashkëpunojnë ngushtësisht me GreenAL duke aplikuar [metodologjinë e përgatitur](#) dhe huazuar mjetet për monitorimin e komponentëve të sipërpërmendur. Patjetër, aplikuesit si ekspertë të fushave përkatëse mund të propozojnë qasjen e tyre për të përmirësuar aplikimin e metodologjisë në terren. Përtej monitorimit të parametrave të cilësisë së ajrit, ujit dhe nivelit të zhurmave synohet të përfshihen në diskutime për rritjen e ndërgjegjësimin dhe advokimit për marrjen e masave për reduktimin e ndotjes në nivele kombëtare.

3.2. LOT 2 (Grante Iniziative)

Aplikuesit për LOT 2 duhet të përqendrojnë veprimtarinë e tyre të propozuar në Bashkinë ose Njësinë Administrative ku kanë legjitimitet për të përfaqësuar çështjet apo komunitetet, bazuar në përvojën e tyre të drejtpërdrejtë.

Disa sygjjerime mbi temat që mund të trajtohen për këtë LOT janë:

- Iniciativa për të rritur ndërgjegjësimin për reduktimin e konsumit dhe emetimeve;
- Iniciativa për përmirësimin e efciencës energjitike në sektorët rezidencial, social dhe publik;
- Iniciativa për vlerësimin e kostove të energjisë elektrike në komunitete dhe kostot sociale;
- Iniciativa për të vlerësuar kostot mjedisore dhe kostot/përfitimet e tranzicionit energjitik;
- Iniciativa për ndërgjegjësimin e komunitetit dhe grupeve të interesit lidhur me masat për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit të fatkeqësive natyrore;
- Iniciativa për vlerësimin e impaktit të gjelbërimit urban;
- Iniciativa për monitorimin e ofrimit të shërbimit të transportit urban në nivel qyteti, bashkie, qarku;
- Iniciativa për mbështetjen e komuniteteve drejt qarkullimit të qendrueshëm;
- Iniciativa për parandalimin e zjarreve në pyje dhe zona të mbrojtura;
- Iniciativa për promovimin e praktikave të mira për ruajtjen e ekosistemeve dhe biodiversitetit;
- Iniciativa për uljen/ricikilimin/ripërdorimin e mbetjeve të gjeneruara në nivel komuniteti;
- Iniciativa për të rritur nivelin e kompostimit në një komunitet;
- Iniciativa për të rritur ndërgjegjësimin dhe ndërveprimin midis komuniteteve të ekspozuara ndaj ndotësve.

***SHËNIM:** Aplikantët të cilët duan të kryejnë monitorimin e ajrit dhe zhurmave, cilësisë së ujrave, shërbimeve të ekosistemit dhe tokës urbane, do të duhet të bashkëpunojnë ngushtësisht me GreenAL duke aplikuar [metodologjinë e përgatitjes](#) dhe huazuar mjetet për monitorimin e komponentëve të sipërpërmendur. Patjetër, aplikuesit si ekspertë të fushave përkatëse mund të propozojnë qasjen e tyre për të përmirësuar aplikimin e metodologjisë në terren.

4. Konsiderata dhe etika

4.1. Konsiderata

Në nivel social: Çështjet mjedisore, veçanërisht ato që janë në fokusin e kësaj thirrje dhe të programit GreenAL, janë komplekse dhe shpesh vështirë të kuptueshme nga të gjithë qytetarët. Për këtë arsye sugjerohet që, në varësi të çështjes së trajtuar dhe grupeve të interesit të targetuar, të përshtaten edhe materialet që do të gjenerohen duke kombinuar materiale shkencore si raporte, letra pozicionimi, ndryshime legjislacioni me materiale lehtësisht të kuptueshme për qytetarët dhe komunitetet si infografikë, vizita në terren, video ilustruese etj.

Gjithashtu, përfshirja e të rinjve duhet të vlerësohet me kujdes, duke adresuar nevojat e tyre dhe duke kombinuar leksionet teorike me ato praktike. Është e rëndësishme të shmanget përfshirja e tyre vetëm për qëllime vizibiliteti, por të sigurohet që ata të kenë një rol aktiv dhe përfitues në këtë proces.

Në nivel mjedisor: Duke qenë se projekti ka në fokus mjedisin, sugjerohet që aplikantët, si gjatë përgatitjes së propozimit ashtu edhe gjatë zbatimit të projektit, të vlerësojnë përfshirjen e elementeve me ndikim minimal në mjedis. Kjo mund të arrihet duke bashkëpunuar me biznese që zbatojnë parimet e ekonomisë qarkulluese ose që gjatë aktivitetit të tyre përdorin materiale të ricikluara.

Në nivel teknik: Aplikantët të cilët do të zgjedhin të kryejnë *investime konkrete* duhet të sigurohen që ky investim të jetë në funksion të projektit dhe përfituesit final janë grupet e interesit dhe komuniteti. Gjithashtu duhet *të evidentojnë qartë impaktin e ndërhyrjes dhe procesin e vijimësisë duke u siguruar që investimi të 'dorëzohet' (marrëveshje bashkëpunimi) zyrtarisht përfituesve fundorë* të cilët do të jenë përgjegjës për mirëmbajtjen e mëtejshme.

Në nivel territorial: GreenAL synon të mbulojë një pjesë të mirë të territorit të vendit për të siguruar që të gjitha komunitetet dhe territoret ndihen të përfaqësuara dhe për të arritur këtë do të marri në konsideratë edhe shpërndarjen territoriale të aplikimeve.

Organizatat të cilat synojnë të aplikojnë për **LOT 1** (Grante Rajonale) do të duhet të jenë të pozicionuara/aktive në rajonin në të cilin kërkojnë të zbatojnë projektin. Në rast se ka aplikantë të cilët nuk janë pozicionuar/aktiv në rajonin në të cilin kërkojnë të zbatojnë projektin ato duhet të justifikojnë shumë mirë lidhjen me rajonin, vlerën e shtuar të ndërhyrjes dhe legjitimitetin e përfaqësimit të komunitetit

Organizatat të cilat synojnë të aplikojnë për **LOT 2** (Grante Iniciative) duhet të përqendrojnë veprimtarinë e tyre në bashkinë, njësinë administrative dhe/ose komunitetin në të cilin kërkojnë të zbatojnë projektin.

Fituesit e granteve të LOT 1 dhe 2, përgjatë kohëzgjatjes së projektit do të duhet të ndërveprojnë ndërmjet tyre dhe me fituesit e granteve tematike dhe rajonale (të thirrjes 16510-G02) si dhe mund të parashikojnë aktivitetet të përbashkëta me GreenAL. **Fituesit e granteve të LOT 1 dhe 2 së bashku me bashkë aplikantët do të duhet të angazhohen në mënyrë aktive në procesin e inkubimit (trajtimeve tematike) që do të zhvillohet nga Partnerët GreenAL në secilin rajon dhe do të duhet të bëhen pjesë e Rrjetit GreenAL.**

4.2. Etika

Konflikti i interesit

Organizatave aplikuese në të dy LOT-et duhet të mos kenë konflikt interesi me asnjë nga organizatat partnere të GreenAL dhe Sida, mbivendosje të aktiviteteve me projekte që janë ende nën marrëdhënie kontraktuale apo të financuara nga palë të tjera. Nëse gjatë zbatimit të marrëveshjes lind ndonjë konflikt interesi, përfituesi duhet të njoftojë menjëherë organizatën grant-dhënëse. Organizatave aplikuese u rekomandohet të shmangin konfliktin e interesit duke mos përfshirë staf nga institucionet me të cilat bashkëpunojnë në zonën e zbatimit të projektit.

Respektimi i të drejtave të njeriut si dhe standardeve bazë të punës

Aplikantët në këtë thirrje (LOT 1 dhe 2) duhet të respektojnë të drejtat e njeriut referuar Kushtetues së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”³. Gjithashtu aplikuesit dhe përfituesit e granteve duhet të zbatojnë standardet bazë të punës së përcaktuara në “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”⁴.

Shkelja e detyrimeve, parregullsitë ose mashtrimi

Co-PLAN rezervon të drejtën të pezullojë ose anulojë procedurën, kur procedura e dhënies së kontratës rezulton se ka qenë objekt i shkeljes thelbësore të detyrimeve, parregullsive ose mashtrimit. Nëse pas dhënies së kontratës zbulohen shkelje thelbësore të detyrimeve, parregullsi ose mashtrim, Co-PLAN mund të tërhiqet nga nënshkrimi i kontratës.

5. Procesi i aplikimit dhe dokumentat e nevojshëm

Procesi i aplikimit për këtë thirrje do të kalojë në katër faza kryesore të cilat janë si më poshtë:

- Aplikimi me projekt propozimin e plotë;
- Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikimeve;
- Zhvillimi i një dëgjese për projekt propozimet që e kanë kaluar pikët minimale të vlerësimit;
- Procedura e përzgjedhjes.

5.1. Aplikimi

Për të kryer aplikimin, aplikantët do të duhet të ngarkojnë dokumentacionin e kërkuar (pika 5.1.1) në hapësirën e dedikuar [në faqen e internetit të GreenAL](#) duke respektuar formatet e aplikimit.

5.1.1. Dokumentacioni i nevojshëm

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikimet për projekt propozime janë si më poshtë dhe duhet të dorëzohen në përputhje të plotë me përcaktimet e këtij dokumenti udhëzues.

Dokumentet kryesore të aplikimit:

1. Format i projekt propozimit (Shtojca 1);
2. Format i buxhetit (Shtojca 2);
3. Format i kornizës logjike dhe planit të punës (Shtojca 3).

Dokumente mbështetës (të nevojshëm nga aplikanti kryesor dhe bashkë aplikantët):

1. Vendim i regjistrimit në gjykatë (kopje);
2. Statuti dhe Akti i Themelimit të organizatës (kopje);
3. Regjistrimi në zyrën e Tatim-Taksave, NIPT (kopje);

³ Ligj Nr. 10 221, Datë 04.02.2010 Për Mbrojtjen nga Diskriminimi

⁴ Ligj Nr. 7961, Datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë

4. Profili Organizativ ku evidentohet qartë përvoja e punës në fushën e mjedisit (CV e aplikantit kryesor dhe bashkë aplikantëve);
5. CV e ekspertëve pjesë e organizatave të cilët do të përfshihen në projekt (ekspertiza duhet të përkojë më rolin që do të mbajë personi përgjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit);
6. Marrëveshje bashkëpunimi në të cilën të evidentohet roli i secilit prej partnerëve (në rast se ka partneritet).

E rëndësishme: Dokumentat e mësipërm do të duhet të dërgohen si nga aplikanti kryesor ashtu edhe nga bashkë aplikantët. Aplikanti kryesor duhet të sigurojë që po dorëzon të gjitha dokumentet mbështetëse të nevojshëm nga partnerët, pasi aplikimet e paplota dhe që nuk plotësojnë rregullat e vendosura, do të refuzohen.

Në rastin e aplikantëve pa buxhet, si dokument mbështetës nga këta aplikant mjafton marrëveshja e bashkëpunimit, ku është i evidentuar qartë roli i tyre në projekt.

5.1.2. Mënyra e aplikimit

Të gjitha dokumentet duhet të ngarkohen në hapsirën e tyre të dedikuar në faqën respektive të grantit në webfaqen e GreenAL.

Çdo **dokument/paketë dokumentash duhet të jetë në format PDF**, me përjashtim të Shtojcës 2 dhe 3 të cilat nevojiten në formatin excel. Çdo dokument/paketë dokumentash **nuk duhet të kaloj kapacitetin prej 5MB**.

Për grantet rajonale, mund të [aplikoni tek kjo faqe](#) duke plotësuar të dhënat e kërkuara dhe duke ngarkuar dokumentet përkatëse, në formatet e specifikuar më sipër, në hapsirat respektive.

Për grantet e iniciativës, mund të [aplikoni tek kjo faqe](#), duke plotësuar të dhënat e kërkuara dhe duke ngarkuar dokumentet përkatëse, në formatet e specifikuar më sipër, në hapsirat respektive.

5.1.3. Afati i fundit për të dërguar aplikimin e plotë

Afati i fundit për dërgimin e aplikimit të plotë është në datë **12.05.2025 ora 16:00**.

Sugjerojmë të gjithë palët e interesuara **të shmangin dorëzimin në momentin e fundit** pasi mund të ketë mbingarkesa të sistemit operativ dhe çdo dorëzim i regjistruar nga sistemi ynë pas orës 16:00 nuk do të trajtohet nga Komisioni i Vlerësimit.

Aplikimi do të konsiderohet i vlefshëm vetëm nëse është dërguar brenda ditës, orarit dhe në respekt me formatin e aplikimit.

Një komunikim me e-mail do t'i dërgohet secilit prej aplikantëve për të konfirmuar marrjen e aplikimit.

5.1.4. Informacione të mëtejshme rreth aplikimit të plotë

Aplikantët mund të dërgojnë pyetje me email në adresën info@greenal.al deri në datën 02.05.2025.

Përgjigjet do të jepen jo më vonë se 5 ditë pune nga marrja e pyetjeve. Co-PLAN nuk ka asnjë detyrim për të dhënë sqarime për pyetjet e marra pas afatit të caktuar për dërgimin e pyetjeve apo sqarimeve.

Për të siguruar trajtim të barabartë të aplikantëve, Co-PLAN nuk mund të japë një opinion paraprak për përshtatshmërinë e aplikantëve kryesorë, bashkë aplikantëve, aplikantëve pa buxhet, një veprimi ose aktiviteteve specifike. Për pyetjet apo sqarimet e kërkuara nuk do të jepen përgjigje individuale por të gjitha përgjigjet për pyetjet apo sqarimet e ardhura, do të publikohen në faqen e internetit të GreenAL.

GreenAL do të organizojë një takim orientues më aplikuesit që do të shpallen fitues në LOT 1 dhe 2 për t'i orientuar mbi kërkesat lidhur me raportimin, buxhetin, vizibilitetin etj.

Vetëm ato projekt propozime të cilat do të kenë marrë pikët e nevojshme (shih pikën 5.2) do të ftohen për të zhvilluar një dëgjese.

5.2. Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikimeve

Një Komision i dedikuar do të ngrihet posaçërisht me vendim të brendshëm nga Co-PLAN, anëtarët e të cilit do të mandatohen për të siguruar një vlerësim objektiv, të paanshëm dhe profesional, ndaj projekt propozimeve të paraqitura.

Vlerësimi është planifikuar të kalojnë në disa hapa të brendshme nga komisioni i vlerësimit.

Hapi 1: Kontrolli administrativ

Kontrolli Administrativ i cili konsiston në:

- Hapjen e aplikimit, folderit digjital;
- Protokollimin/Regjistrimin e detajuar të materialeve pjesë e aplikimit;
- Vlerësimin e vlefshmërisë së tyre.

Përgjatë vlerësimit, më në detaj do të kontrollohen:

Kriteret Administrative	Po	Jo	Komente
Propozimi është dorëzuar brenda afatit dhe rregullave.			
Aplikanti/ët i plotëson/jnë kriteret e specifikuar në pikat 2.2.1, 2.2.2. dhe 2.2.3 në udhëzues.			
A është respektuar formatin e kërkuar i shtojcës 1? (A janë plotësuar të gjitha pikat në format?)			
A është respektuar formati i duhur i shtojcës 2?			
A është respektuar formati i duhur i shtojcës 3?			
A është aplikanti me vendodhje në rajonin/bashkinë/njësinë administrative ku po aplikon?			
Dokumentet Mbështetës	Po	Jo	Komente

Vendimi i regjistrimit në gjykatë (kopje elektronike) <i>* të aplikantëve kryesor dhe bashkë aplikantëve</i>			
Statuti dhe Akti i Themelimit të organizatës (kopje elektronike) <i>* të aplikantëve kryesor dhe bashkë aplikantëve</i>			
Regjistrimi në Zyrën e Tatim-Taksave (NIPT) (kopje elektronike) <i>* të aplikantëve kryesor dhe bashkë aplikantëve</i>			
Profili Organizativ ku evidentohet qartë përvoja e punës në fushën mjedisit/CV e organizatës. <i>* të aplikantët kryesor dhe bashkë aplikantëve</i>			
CV e ekspertëve kyc të brendshëm* e të jashtëm, të cilët do të përfshihen në projekt. <i>* që janë pjesë e stafit të brendshëm të aplikantit kryesor ose bashkë aplikantëve</i>			
Marrëveshje bashkëpunimi <i>* Midis të gjithë aplikantëve (kryesor, bashkë aplikant dhe atyre pa buxhet)</i>			
Buxheti, kohëzgjatja dhe nr. i aplikimeve	Po	Jo	Komente
Buxheti total i projektit është brenda limiteve të kërkuara			
Kohëzgjatja e projektit si më poshtë: Për aplikantët e LOT 1: 18 - 24 muaj Për aplikantët e LOT 2: 12 – 18 muaj			
A është aplikuesi konform numrit të aplikimeve të specifikuar për secilin LOT? <i>(ref. pikës 2.2.4. të udhëzuesit)</i>			
A është formuar partneritet me të paktën 3 OSHC, për aplikantët në LOT 1? (1 lider OSHC mjedisore dhe 2 OSHC të tjera)			
A është formuar partneritet me maksimalisht 2 OSHC, për aplikantët në LOT 2? <i>(Nëse aplikimi në LOT 2 përmban vetëm 1 aplikant kryesor, atëherë plotësohet ky kriter)</i>			

Të gjithë ata aplikantë të cilët nuk plotësojnë kërkesat e sipërpërmendura do të s'kualifikohen dhe do të njoftohen respektivisht.

Hapi 2: Vlerësimi cilësor/përmbajtësor i aplikimit

Cilësia e aplikimeve, duke përfshirë buxhetin e propozuar dhe kapacitetin e aplikantëve, do të vlerësohet duke përdorur kriteret e vlerësimit të plotë që paraqiten në tabelën më poshtë.

Kriteret e vlerësimit do të ndahen si më poshtë: 1 = shumë e dobët; 2 = i dobët; 3 = adekuate; 4 = mirë; 5 = shumë mirë.

Relevanca	Rezultati maksimal (pikë)
1. Kapaciteti operacional / teknik	10 pikë
A ka aplikanti ekspertizë të mjaftueshme tematike dhe eksperiencë të mëparshme me rrjete, veçanërisht njohuri për çështjet që do të adresohen në lidhje me mjedisin? <i>Ref. pika 4.5.b, 7 e Shtojcës 1; Profili organizativ/CV</i>	5 (pikë)
A ka aplikanti kapacitet të mjaftueshëm menaxhues, përfshirë stafin e brendshëm dhe aftësinë për të trajtuar buxhetin për aktivitetet e parashikuara? <i>Ref. pika 4.5.b, 7 e Shtojcës 1; Profili organizativ/CV dhe CV të stafit</i>	5 (pikë)
2. Rëndësia e veprimit	20 pikë
Sa i rëndësishëm është propozimi për adresimin, trajtimin apo zgjidhjen e çështjes mjedisore në rajonin/bashkinë/njësinë përkatëse? <i>Ref. pika 4a, 4.1.a, 4.1.b, 4.1.c e Shtojcës 1</i>	5 x 2**, 10 (pikë)
Sa qartë janë përcaktuar dhe zgjedhur aktorët e përfshirë (përfutuesit përfundimtarë, grupet e synuara) dhe është detajuar si do të afrohen dhe përfshihen aktorët? <i>Ref. pika 4.1.d, 4.2a, e Shtojcës 1</i>	5 (pikë)
A janë përcaktuar qartë nevojat e aktorëve të përfshirë dhe a i adreson propozimi ato në mënyrë të përshtatshme? <i>Ref. pika 4.2a e Shtojcës 1</i>	5 (pikë)
3. Projektimi i veprimit	20 pikë
Sa koherent është modeli i përgjithshëm i veprimit? Në veçanti, a pasqyron ai analizën e problemeve, a ka marrë parasysh faktorët e jashtëm dhe palët e interesuara përkatëse? <i>Ref. pika 4.4.a, 4.5.a, 4.6.a, 4.6.b e Shtojcës 1 ; Shtojca 3 - Korniza Logjike.</i>	5 x 2**, 10 (pikë)
A është veprimi i realizueshëm dhe në përputhje me objektivat dhe rezultatet e pritura të projektit që do të zbatohet?	5 x 2**, 10 (pikë)

<i>Ref. pika 4.3, 4.5.c e Shtojcës 1; Shtojca 3 – Plani i Punës.</i>	
4. Efektiviteti dhe zbatueshmëria e propozimit	15 pikë
A sjell risi në adresimin e problemit modeli i propozuar nga aplikanti? <i>Ref. 4d, 4.5.a e Shtojcës 1</i>	5 (pikë)
A është i qartë dhe i realizueshëm plani i veprimit dhe a janë paraqitur indikatorët mbi të cilët do vlerësohet përmbushja e objektivit të propozimit? <i>Ref. 4.b e Shtojcës 1; Shtojca 3 - Plani i punës</i>	5 x 2**, 10 (pikë)
5. Buxheti dhe efektiviteti i kostos	20 pikë
A janë pasqyruar në mënyrë efektive kostot e aktiviteteve në buxhetin e propozuar? <i>Ref. Shtojca 2 – Buxheti, Shtojca 3 – Plani i aktiviteteve</i>	5 x 2**, 10 (pikë)
A është racional raporti midis kostove dhe rezultateve të pritura? <i>Investimet e parashikuara do të jenë subjekt vlerësimi të detajuar dhe miratimi vetëm nga ana e Co-PLAN.</i> <i>Ref. Shtojca 2 – Buxheti, Shtojca 3 – Plani i aktiviteteve</i>	5 x 2**, 10 (pikë)
6. Qëndrueshmëria e projektit	10 pikë
A ka gjasa që veprimi të ketë një ndikim të prekshëm në grupet e tij të synuara?	5 (pikë)
A ekziston mundësia që veprimi të gjenerojë efekte shumëfishuese, duke përfshirë potencialin për përsëritje, zgjerim, kapitalizim të përvojës dhe ndarje të njohurive? <i>Ref. pika 4.6.c e Shtojcës 1.</i>	5 (pikë)
7. Komponenti gjinor	5 pikë
A ka marrë aplikanti në konsideratë ose ka integruar perspektivën gjinore në projekt propozim dhe e ka lidhur atë me tematikën e trajtuar? <i>P.sh. Integrimi i objektivave specifike gjinore, tregues/indikatorë të ndjeshëm gjinorë sasiore dhe cilësorë, stafi i projektit përbëhet nga gra ose 30 deri në 50% gjinia më pak e përfaqësuar dhe grate ose gjinia më pak e përfaqësuar mbajnë role vendimmarrëse, etj.</i> <i>Ref. pika 4.2.b e Shtojcës 1</i>	5 (pikë)
PIKËT TOTALE MAKSIMALE	100 (pikë)

****:** Në këto raste rezultati nga 1-5 shumëzohet me 2 për shkak të rëndësisë së tij.

Pasi të jetë kryer vlerësimi i projekt propozimeve, vetëm ato propozime të cilat do të kenë marrë **të paktën 70 pikë** do të ftohen për të zhvilluar një dëgjësë.

5.3. Zhvillimi i dëgjësës

Aplikantët të cilët kanë fituar pikët e nevojshme nga vlerësimi i projekt propozimit do të ftohen të zhvillojnë një dëgjësë e cila do ti mundësojë aplikuesit të prezantojnë idenë e tyre përpara Partnerëve GreenAL. Data respektive e dëgjësës do i komunikohet aplikantëve që do ftohen në dëgjësë. Gjatë dëgjësës një (1) person nga aplikanti kryesor do të ketë mundësi të prezantoj elementët kryesore të idesë së aplikantit/aplikantëve gjatë një minutazhi të kufizuar (5-10 minuta).

Pas dëgjësës ekipi i vlerësimit do të japi një vlerësim të përgjithshëm të temës së trajtuar sipas tabllës së mëposhtme.

Kritere	Rezultati maksimal (Pikë)
Është e qartë tematika e përzgjedhur dhe plani i veprimit për të trajtuar atë?	5 pikë
A janë të arritshëm indikatorët dhe rezultatet e vendosura?	5 pikë
A kanë aplikuesit kapacitete të brendshme të mjaftueshme për të trajtuar temën respektive?	5 pikë
A është i qartë impakti që do të ketë në rajon/komunitet/bashki?	5 pikë
A është buxheti i kërkuar i arsyeshëm për veprimin e ndërmarrë?	5 pikë
A është komponenti gjinor lehtësisht i evidentueshëm në nismë?	5 pikë
Pikë maksimale	30 pikë

Kriteret e vlerësimit do të ndahen si më poshtë: 1 = shumë e dobët; 2 = i dobët; 3 = adekuate; 4 = mirë; 5 = shumë mirë.

5.4. Procedura e përzgjedhjes

Pas dëgjësës, do të hartohet një tabelë ku do të renditen aplikimet sipas pikëve të tyre, ku:

- pikët e marra përgjatë vlerësimit cilësor të aplikimit do të përmbajnë 80% të peshës së vlerësimit përfundimtar;
- pikët e marra përgjatë vlerësimit të dëgjësës do të përmbajnë 20% të peshës së vlerësimit përfundimtar.

Aplikimet me pikët më të larta do të zgjidhen përkohësisht derisa të arrihet buxheti i disponueshëm për secilin LOT në këtë thirrje për propozime.

Në rast aplikimesh me të njëjtën sasi pikësh, përparësi në listë do t'u jepet aplikimeve që kanë shënuar pikë më të lartë sipas seksionit 2 të Formatit të Vlerësimit Cilësor (si më sipër). Në rast të pikëve të barabarta në seksionin 2, atëherë përparësi do tu jepet aplikimeve që kanë shënuar pikë më të lartë në seksionin 3 të Formatit të Vlerësimit Cilësor (si më sipër). Në rast të pikëve të barabarta në seksionet 2 dhe 3, përparësi do t'i jepet pikës së caktuar në seksionin 5, pastaj 4, pastaj 6, pastaj 1 dhe 7.

Aplikimet e renditura nën limitin e buxhetit të disponueshëm për thirrjen në të cilën kanë aplikuar mund të jenë përfituese të grantit në rast se gjatë procesit të negociatës ndërmjet Co-PLAN dhe aplikantit të para përzgjedhur nuk arrihet një dakordësi finale.

Në përfundim të zhvillimit të procesit të vlerësimit, Co-PLAN do të njoftojë të gjithë aplikantët me shkrim për vendimin e Komisionit Vlerësues në lidhje me aplikimet e dorëzuara. Në letrën përcjellëse për njoftimin e rezultatit do të paraqiten pikët e grumbulluara nga aplikanti (mesatare e vlerësimit e të gjitha vlerësimeve nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit si ato cilësore dhe ato të dëgjësës). Kjo letër do të dërgohet e skanuar me e-mail drejt aplikantit kryesor.

Aplikantët të cilët besojnë se janë vlerësuar negativisht si rezultat i ndonjë gabimi apo parregullsie gjatë procesit të vlerësimit mund të kryejnë një **ankimim me shkrim**, brenda 5 (pesë) ditëve (ditë pune) nga dita që kanë marrë njoftim për refuzim. Të gjitha ankesat do të shqyrtohen dhe përgjigja do të kthehet brenda 5 ditëve (ditë pune) nga paraqitja e ankimit.

Për të siguruar një mbulim sa më të gjerë të temave mjedisore, shpërndarje të drejtë të fondeve dhe mbulim të gjerë territorial, ritheksojmë se Co-PLAN rezervon të drejtën të përzgjedh ndërmjet aplikimeve të parakualifikuara në favor të një mbulimi të gjerë territorial dhe diversiteti të temave të trajtuara.

5.4.1. Njoftimi i vendimit nga ana e Co-PLAN

Pas vendimit për dhënien e një granti, përfituesit do t'i ofrohet një marrëveshje e cila do të zyrtarizojë edhe marrdhënien kontraktuale ndërmjet palëve.

5.5. Kontraktimi:

Përpara nënshkrimit të kontratës, Co-PLAN (si përgjegjës për zbatimin e skemës së granteve) rezervon të drejtën për të negociuar me aplikuesin në mënyrë që të sigurojë efikasitetin maksimale për shpenzimet e parashikuara në kuadër të këtij projekti. Në këtë drejtim, Co-PLAN mund të sigjerojë aplikantëve fitues ndryshimet përkatëse në zërat e buxhetit dhe aktivitetet e propozuara për të qenë në linjë me parimet e përgjithshme të skemës së granteve.

Në rast se gjatë fazës së negociatës palët (Co-PLAN dhe aplikanti) nuk arrijnë në një dakordësi mbi ndryshimet e sugjeruara, Co-PLAN mund të vendosi të financojë projektin e radhës të renditur sipas numrit rendor në vlerësimin e përgjithshëm të aplikimeve.

5.6. Kontratat, raportimet dhe pagesat përfundimtare

Pagesa do të planifikohet në 3 faza kryesore:

- i. Përfituesit do të marrin paradhënie, 40% të shumës totale të grantit pas nënshkrimit të kontratës;
- ii. Kësti i dytë prej 40% do të përftohet pas miratimit të raportimit narrativ dhe financiar të ndërmjetëm dhe pasi të jetë vërtetuar shpenzimi i 70% e shumës së kështit të parë;
- iii. Pagesa përfundimtare (20%) do të transferohet pas miratimit të përditësimeve të raportit përfundimtar narrativ dhe financiar.

SHËNIM: Organizatat duhet të parashikojnë një kosto për auditim të jashtëm si pjesë e buxhetit të tyre, për raportin përfundimtar financiar të projektit.

5.7. Kalendar Indikativ i Procesit

KALENDAR INDIKATIV I PROCESIT		
Hapi i thirrjes	Data	Ora
Shpallja publike e Thirrjes për Projekt - Propozime	07/04/2025	
Katër (4) sesione informimi	07/04/2025 – 02/05/2025	
Afati i fundit kohor për të drejtuar pyetje sqaruese Co-PLAN.	02/05/2025	16:00
Data në të cilën publikohen sqarimet (FAQs) nga Co-PLAN	05/05/2025	16:00
Afati i fundit për dorëzimin e projekt propozimeve	12/05/2025	16:00
Informimi i aplikantëve mbi marrjen e projekt propozimeve (Nr. Prot)	16/05/2025	16:00
Njoftim i aplikantëve mbi vlerësimin administrativ	23/05/2025	16:00
Zhvillimi i dëgjësive për projekt propozimet që kanë kaluar pikët minimale	09/06/2025 - 13/06/2025	
Njoftimi i aplikantëve për rezultatet	18/06/2025	16:00
Afati i fundit në dispozicion për ankimim	25/06/2025	16:00
Kthim përgjigje për ankimimet	02/07/2025	16:00
Negociatat për firmosjen e kontratave	30/06/2025 - 04/07/2025	16:00
Ceremonia e firmosjes së granteve	07/07/2025 - 11/07/2025	

Shënim: Ky është një kalendar i cili për shkak të situatave të papritura mund të pësojë ndryshime.